



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

INSPEKTORATI SHTETËROR SHËNDETËSOR

**LIST VERIFIKIMI MBI INSPEKTIMIN E MASAVE PËR
PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË COVID 19**

- LIGJI 15/2016 DATË 10.03.2016 “PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E INFEKSIONEVE DHE SËMUNDJEVE INFEKTIVE”.
- AKT NORMATIV Nr. 2, datë 11.3.2020 PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.15/2016, “PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E INFEKSIONEVE DHE SËMUNDJEVE INFEKTIVE”
- AKT NORMATIV NR. 3 DATË 15.03.2020 “ PËR MARRJEN E MASAVE TË VECANTA ADMINISTRATIVE GJATË KOHËZGJATJES SË PËRIUDHËS SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19”
- URDHËR NR 156 DATË 10.03.2020 I MINISTRIT TË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE “ PËR MARRJEN E MASAVE TË VECANTA NË PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19”, I NDRYSHUAR.
- URDHËR NR 305 DATË 08.05.2020 I MINISTRIT TË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE “ PËR MENYRËN E VETËKARANTINIMIT E PERSONAVE QË RIATDHESOHEN”.

1.	Ligji 15/2016 neni 6, pika 1 (a,b,c,ç,d,dh,e,f) Akt normativ nr.2 datë 11.03.2020, neni 3,pika b	A janë marrë masat e përgjithëshme për mbrojtjen nga sëmundjet infektive?		
Komente:				
2.	Ligji 15/2016 neni 7, pika 1,b Urdhër MSH nr.156 datë 10.03.2020	A plotësojnë skedën e udhëtarit në pikat hyrëse kufitare personat që kanë hyrë në Shqipëri nga zonat e kuqe për COVID?		
Komente:				

3.	Ligji 15/2016 2020, Neni 21 pika 4, Urdhër MSH nr.156 datë 10.03.2020, i ndryshuar Akt normativ nr.3 datë 15.03.2020, Neni 3, pika 4(a,b,c,ç), Urdher 305 date 08.05.2020.	A zbatohet karantinimi dhe izolimi i personave sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik ?” a. Shtetasi, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk deklaron ardhjen e tij nga zonat e prekura nga infeksioni COVID-19 b. Shtetasi, i cili hyn nga zonat e prekura në territorin e Republikës së Shqipërisë, që nuk vetëkarantinohet për një periudhë 14-ditore në ambientet e banesës së tij c. Shtetasi, i cili vjen nga zonat e prekura dhe nuk zbaton urdhrin e dhënë nga organet kompetente për vetëkarantinimin e detyrueshëm d. Shtetasi, i cili ka rezultuar pozitiv dhe nuk zbaton urdhrin e dhënë nga organet kompetente për vetëkarantinimin e detyrueshëm.		
Komente:				
4.	Ligji 15/2016 neni 7, pika 4 Akt normativ nr. 3 datë 15.03.2020, Neni 3, pika 3	A ndalohet hyrja e shoqëruesve dhe/ose e familjarëve të pacientëve në ambientet e shërbimit të urgjencës mjekësore, institucionet e kujdesit shëndetësor, ambientet e shërbimit spitalor ku janë duke marrë trajtim spitalor pacientët, vetëm me përjashtim të rasteve kur një kërkesë e tillë vjen nga drejtoria spitalore?		
Komente:				
5.	Ligji 15/2016 neni 7, pika 4 Akt normativ nr.3 datë 15.03.2020, neni 3, pika 2	A organizon subjekti aktivitete publike dhe jopublike, aktivitete sportive, kulturore dhe konferenca, apo grumbullime masive në vende të mbyllura apo të hapura si koncerte, dëgjesa publike etj?		
Komente:				
6.	Ligji 15/2016 neni 7, pika 4 Akt normativ nr.3 datë 15.03.2020, neni 3, pika 6	A ka mbyllur aktivitetin subjekti i dedikuar për argëtimin e fëmijëve dhe të rinjve , palestra, qendra sportive, pishina, qendra kulturore, qendra argëtimi, qendrat e internetit, qendrat kulturore ?		
Komente:				
7.	Ligji 15/2016 neni 7, pika 4 Akt normativ nr.3 datë 15.03.2020, neni 3, pika 7	A respektojnë subjektet apo individët urdhërat e dhëna nga organet kompetente për mbylljen e bareve , lokaleve, restoranteve dhe klubeve?		
Komente:				
8.	Ligji 15/2016 neni 7, pika 4 Akt normativ nr.3 datë 15.03.2020, neni 3, pika 8	A janë pezulluar përkohësisht aktivitete sportive, sociale dhe kulturore dhe eskursionet mësimore brenda dhe jashtë vendit?		
Komente:				

9.	Akt normativ nr.3 datë 15.03.2020, Neni 3, pika 10	A ndalohet grumbullimi i pacientëve në ambientet e brendëshme apo strukturat e veçanta të institucioneve të kujdesit shëndetësor, të poliklinikave, të spitaleve, publike e jopublike, ku zhvillohen vizita dhe konsulta ambulatorie ?		
Komente:				
10.	Akt normativ nr.3 datë 15.03.2020, Neni 3, pika 13	A respektohet nga të të gjitha transmetimet audiovizive prania e jo më shumë se dy personave në të njëjtën studio televizive?		
Komente:				
11.	Akt normativ nr.3 datë 15.03.2020, Neni 3, pika 16	A janë në dispozicion edhe strukturat private spitalore, ambulatorie, hoteliere, autoambulancat dhe personeli përkatës, shëndetësor e mbështetës sipas urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë ?		
Komente:				